



HISTORIKU I SHKURTËR I SHFMU "EMIN DURAKU" NË BANULLË

SHFMU "Emin Duraku" në Banullë përherë të parë e filloi procesin edukativo-arsimor në vitin shkollor 1925/1926. Mësimin shkolla jonë e kishte filluar në gjuhën serbo-kroate dhe me mësues serb.

Mësimi u zhvillua në kushte mjaft të vështira dhe në gjuhën jo amtare. Mësuesit serb ishin Millorad Hoxhiq dhe Urosh Nedelkoviq. Gjendja ekonomike e popullit shqiptarë ishte e vështirë nga shtypja e pushtuesit serb. Hapja e shkollave aso kohe më tepër ishte bërë për nevojat politike të sistemit serb. Mësimi në gjuhën serbe ishte zhvilluar deri sa kishte filluar Lufta e dytë Botërore, më 1939. Gjatë viteve të Luftës së dytë Botërore mësimi ishte ndërprerë. Hoxha i fshatit, Aziz Haziri gjatë kohës së okupi mit të ish Jugosllavis, i cili krahas mësimit fetar nxënësve u mësonte edhe për historinë, kulturën dhe traditën shqiptare.

Mësimi në gjuhën shqipe në shkollën e Banullës ka filluar që nga viti 1945 d.m.th. pas mbarimit të luftës së dytë botërore.

Në fshatin tonë mësimet i ndiqnin edhe nxënësit e fshatrave Gllogovc dhe Gumnasellë.

Mësimin me këta nxënës në gjuhën shqipe për herë të parë pas çlirimit e filluan Sherif Ahmeti dhe Hamdi Bislimi, që të dy nga fshati Gumnasellë.

Fillimisht mësimi u zhvillua deri në klasën e katërtë, kurse nga klasa e pestë e deri në klasën e tetë nxënësit mësimet i vijonin në shkollën e Lipjanit. Gjendja ekonomike e popullit tonë ishte e vështirë, prandaj edhe udhëtimi i nxënësve ishte shumë i vështirë. Përkundër kushteve të vështira ineteresimi për shkollim ishte shtuar shumë nga ana e nxënësve dhe e prindërve.

Duke patur parasysh të gjitha këto vështërsi që fëmijët e këtyre fshatrave, të cilët vijonin mësimet në shkollën e Lipjanit, Këshilli Popullor i komunës sonë kishte vendosur që ta ndërtoj një objekt të ri shkollor në mes të tri fshatrave gjegejisht në fushën e fshatit Banullë. Shkolla që nga themelimi e mban emrin e heroit tonë popullor "Emin Duraku".

Puna edukativo-arsimore në objektin shkollor të sa po ndërtuar kishte filluar punën në vitin shkollor 1962/63. Objekti shkollor u përshtatej kushteve për zhvillimin e mësimimit në bazë të normave pedagogjike, njëherit ishte e paisur mirë edhe me mjete mësimore.

Drejtor i parë i shkollës sonë nga Këshilli Komunal i Lipjanit ishte emëruar Shyqeri Haziri nga fshati Banullë.

Shkolla jonë ishte bërë qendër arsimore për këtë teritor në të cilin marrin pjesë fshatrat e përmendura më parë si dhe Qallapeku një fshat më i vogël në krahasim me fshatrat Banullë, Glllogovc dhe Gumnasellë.

Pra, duhet theksuar se shkolla jonë kur e filloi punën në vitin shkollor 1962/63 kishte 418 nxënës dhe 18 mësime të mësuara.

Në janar të vitit 1963 shkollës sonë iu bashkuan edhe paralelet e ndara të Llugaxhisë dhe Rubovcit, të cilat gjatë atëherë kishin qenë paralele të ndara të shkollës së Gadimes.

Në vitin shkollor 1972/73 numri i nxënësve kishte arritur në 820 dhe personeli arsimor në 40. Pra, në vitin shkollor 1972/73 ngritet kati i dytë shkollës, kështu që nxënësve u krijohet hapësirë e nevojshme dhe shkolla paiset edhe me kabinete të reja.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës nga Serbia në vitin vitin 1989 gjendja e arsimit shqip në mbarë Kosovën ishte rënduar shumë. Serbia kishte okupuar shumicën e institucioneve kosovare dhe mendohej me forma të ndryshme të impononte planprogramet e tyre mësimore. Kishte mbyllur shumë shkolla, ndërpret financimin, fillon me maltrime dhe burgosje të mësime të mësuara etj.

Kështu që marsi i vitit 1991 ishte muaji kur në shkollën tonë mësimi zhvillohej në tri ndërrime, ngase tani nxënësve tanë iu bashkangjiten edhe nxënësit e shkollës së mesme “Ulpiana” nga Lipjani, të cilët me dhunë policia serbe i dëboi nga objekti i tyre shkollor. Njëherit në shkollën tonë mësimet i ndoqën edhe shumë fëmijë të tjerë të larguar nga zonat e luftës.

Edhe mësime të mësuara e shkollës sonë, sikurse të gjithë ata në tërë Kosovën për asnjë moment nuk u larguan nga nxënësit dhe se trasuan rrugën e të parëve të tyre. Përkundër të gjitha trazirave ajo mbeti simbol i qëndresës, i punës së palodhshme dhe përgjegjësisë për rolin dhe detyrën që kishte. Në vazhdimësi bëhej përpjekje për cilësi në procesin e mësim të mësuara duke mos lënë anash edhe aktivitetet e lira, të cilat begatonin jetën kulturore, artistike e sportive të kësaj treve, gjë që nuk mungojnë as dëshmitë e sukseseve nëpër garat e zhvilluara në nivel komunal, por edhe në ato të Kosovës.

Shkolla e fshatit Llugaxhi u pavarësua në vitin shkollor 1993/94, kurse ajo e Rubovcit në vitin shkollor 1997/98.

Vitin shkollor 2015/2016 mësimin e filluam në tri objekte shkollore: Banullë dhe Glllogovc (objekte të reja ndërtimi i të cilave kishte filluar disa vite më parë), kurse nxënësit e fshatit Bujari mësimet i ndoqën në objektin e vjetër shkollor.

Në fshatin Bujari punët e filluara rreth ndërtimit të objektit shkollor, që kishin filluar diku para dy viteve përfunduan nga fundi i muajit nëntor 2017 dhe përfundimi i shkollës së re u bë më 02.12.2017.

Sipas vendimi të MASHT-it që nga fillimi i vitit shkollor 2017/18 shkolla e Gllgovcit është e pavarur.

Gjatë dy viteve të fundit jemi ballafaquar me probleme të mëdha si pasojë e koronavirusit COVID 19, por megjithatë ia kemi dale që të kemi suksese të mira.

Gjatë vitit shkollor 2020/2021 në kuadër të shkollës sonë kemi edhe PNF në Bujari, ku mësimi zhvillohet që nga parafillori e deri në klasën e nëntë, kurse në PNF Qallapek mësimi zhvillohet nga klasa e parë e deri në klasën e katërtë (mësimi zhvillohet në klasa të kombinuara).

Gjatë vitit shkollor 2020/2021 ishin të regjistruar 408 nxënës, për edukimin e të cilëve ishin të angazhuar 35 mësime.